



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2254 Dt 23.11.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, nenit 18, paragrafi 3 dhe nenit 24 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2021, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet draft- Rregullorja për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve tjera për studentë.
- II. Pjesë e këtij vendimi është edhe Rregullorja për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve tjera për studentë.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Fakulteteve.
3. Parlamentit Studentor
4. Zyrës për komunikim me publikun



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së
Prof. asoc. dr. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2254 Dt 23.11.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, nenit 18, paragrafi 3 dhe nenit 24 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2021 miratoi:

**RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE DHE SHPËRBLIMEVE TJERA PËR
STUDENTËVE**

Neni 1

Fushëveprimtaria

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e procesit të ndarjes së bursave për studentë. Bursë për studentë konsiderohet shuma financiare e ndarë nga Universiteti për studentët e nivelit Bachelor dhe Master gjatë një viti akademik që plotësojnë kriteret e paracaktuara me këtë rregullore.

Neni 2

Llojet e bursave

Universiteti me anë të konkursit përcakton kushtet për aplikim për bursë studentore për nivelin e studimeve dhe llojin e bursës:

Bursë studentore është shuma financiare të cilën e përfitojnë studentët që plotësojnë kriteret e paracaktuara me këtë rregullore.

Neni 3

Buxheti dhe lartësia e bursës

Lartësia e shumës financiare të bursës përcaktohet nga kriteret e mëposhtme:

3.1 Nga numri i studentëve që përmbushin kushtet për përfitimin e bursës

3.2 Nga buxheti i ndarë nga Universiteti për këtë destinim

3.3 Lartësia e bursës universitare do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit, për çdo vit akademik, me një vendim të veçantë, varësisht nga buxheti dhe numri i studentëve që i plotësojnë kushtet.

Neni 4

Kriteret për përfitimin e bursave

Kushtet për aplikim për bursë studentore janë:

4.1 të jenë student të rregullt të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë,

4.2 të jenë student të vitit të dytë e më lart,

4.3 të mos kenë vit të përsëritur të studimeve,

4.4 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit,



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

4.5 të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:

4.5.1 Tetë pikë zero (8.0) – për studentët e nivelit të studimeve Bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike; dhe

4.5.2 Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët nivelit të studimeve Bachelor të Fakultetit Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.

4.5.3 Tetë pikë pesë (8.5) – për studentët e nivelit të studimeve Master në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;

4.5.4 Nëntë pikë zero (9.00) – për studentët e nivelit të studimeve Master të Fakultetit Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit.

Neni 5

Pengesat dhe ndalesat për dhënien e bursës studentore

Studentët të cilët plotësojnë kriteret nga Neni 4, por nuk mund të marrin bursë nga Universiteti janë:

5.1 Studentët ndaj të cilëve Komisionet disiplinore kanë shqiptuar masa disiplinore gjatë studimeve në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", të cilëve nuk ju takon bursa.

5.2 Studentët që janë të dënuar nga gjykata me aktgjykim të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm për vepër penale gjatë kohës së studimeve.

5.3 Pjesë e aplikimit do të jetë edhe deklarata nën betim nga studenti se i njëjti nuk ka ndalesa për ndarjen e bursës siç parashihet në dy nënparagrafët e mësipërm.

5.4 Zyra Ligjore në kuadër të Rektoratit përgatit formularin e deklaratës nga paragrafi 2 i këtij neni.

5.5 Deklarata plotësohet dhe nënshkruhet nga secili student që aplikon për bursë.

Neni 6

Afatet procedurale

Afatet kohore për fillimin dhe përfundimin e procedurave të konkursit të bursave të studentëve:

6.1 Afati për aplikim për bursa të studentëve duhet të jete se paku 7 (shtatë) ditë, e më së shumti 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së konkursit.¹

6.2 Afati për shqyrtim të aplikimeve dhe shpallje të përftuesve duhet të jetë jo më shumë se 5 ditë pune.

6.3 Afati për ankesa nga studentët pas shpalljes së rezultateve është 2 ditë pune.

6.4 Afati për shqyrtim të ankesave nga komisioni për ankesa është 2 ditë pune.

¹ Kohëzgjatja e konkursit përcaktohet me vendim të Këshillit drejtues çdo vitë akademik, varësisht nga dinamika e proceseve akademike



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Neni 7

Komisioni për ndarjen e bursave

Vlerësimin e aplikimeve për bursa të studentëve e bën komisioni i emëruar nga Këshilli drejtues i Universitetit. Ky komision në përbërje duhet të ketë 3 (tre) anëtarë:

- 7.1 Një përfaqësues i Këshillit drejtues
- 7.2 Një përfaqësues i stafit akademik (me titull së paku Profesor asistent)
- 7.3 Një përfaqësues i zyrës ligjore
- 7.4 Parlamenti studentor mund të dërgoj një (1) përfaqësues (student) si vëzhgues (pa të drejtë vote), i cili nuk është pjesë e konkursit.
- 7.5 Komisioni mbanë përgjegjësi ligjore për punën e tij.

Neni 8

Komisioni për ankesa

Këshilli drejtues njëkohësisht emëron Komisionin dhe kryesuesin e komisionit për ankesa i cili në përbërje ka 3 (tre) anëtarë:

- 8.1 Një anëtarë të Këshillit drejtues
- 8.2 Prorektori i Universitetit për çështje financiare
- 8.3 Sekretari i Universitetit
- 8.4. Komisioni vepron në bazë të ankesave të palëve dhe vendimet i merr në pajtueshmëri me Ligjin për Procedurën Administrative, Statutin e Universitetit, këtë Rregullore dhe konkursin për bursa.
- 8.5. Komisioni mbanë përgjegjësi ligjore për punën e tij.

Neni 9

Shpallja e konkursit

Shpallja e konkursit për bursa duhet të bëhet në afat kohor jo më shumë se 60 ditë pas mbylljes së afatit për regjistrim të semestrit dimëror.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 23.11.2021.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2283 Dt 25.11.2021

Në bazë të nenit 8 të Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve tjera për studentë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2021, mori:

VENDIM

- I. Për emërimin e Komisionit për ankesa të studentëve për vitin akademik 2020/2021.
- II. Komisioni nga pika I e këtij vendimi ka këtë përbërje:
 1. Salem Lepaja- kryesues
 2. Ajtene Avdullahi- anëtar
 3. Xhelal Smakiqi- anëtar.
- III. Komisioni ka vepron në bazë të ankesave eventuale të palëve lidhur me ndarjen e bursave për vitin akademik 2020/2021 dhe vendimet i merr në pajtueshmëri me Ligjin për Procedurën Administrative, Statutin e Universitetit Rregulloren për ndarjen e bursave dhe konkursin e shpallur për bursa.
- IV. Kryetari i komisionit është i obliguar që të thërrasë mbledhjet e komisionit.
- V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Anëtarëve të Komisionit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja

Nr. Prot. 2282 Dt 25.11.2021

Në bazë të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve tjera për studentë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2021, mori:

VENDIM

- I. Për emërimin e Komisionit për ndarjen e bursa të studentëve për vitin akademik 2020/2021.
- II. Komisioni nga pika I e këtij vendimi ka këtë përbërje:
 1. Ilir Mazreku- kryesues
 2. Qazim Tmava- anëtar
 3. Avdyl Beqiri- anëtar.
- III. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e studentëve për përfitim të bursës universitare në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve tjera për studentë dhe konkursin për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2020/2021.
- IV. Kryetari i komisionit është i obliguar që të thërrasë mbledhjet e komisionit dhe në afat sa më të shkurtër të paraqesin listat e studentëve që i plotësojnë kriteret për përfitim të bursës universitare për vitin akademik 2020/2021.
- V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Anëtarëve të Komisionit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Prof. asoc. Dr.techn. Salem Lepaja